



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS LEZHE

Nr. 247 Prot.

Lezhe më, 17 02 2026

VENDIM Nr. 20

Sot, më datë 17.02.2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Lezhe, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në lidhje me konstatimin e mbajtur në ngarkim të subjektit "AMN - GROUP ALBANIA" – Shpk me NIPT L77524301J,

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa nr.1404/9 Prot., datë 11.08.2025 me lëndë "Dërgohet raporti final për auditimin e kryer në Doganën Lezhe" Ne zbatim të Raportit Final të Auditit të Brendshëm ndaj subjektit "AMN - GROUP ALBANIA" – Shpk me NIPT L77524301J ne Degen e Doganes Lezhe eshte mbajtur procesverbali perkates date 30.10.2025.

Rezulton se subjekti "AMN - GROUP ALBANIA" – Shpk me NIPT L77524301J eshte pajisur me Autorizimin per perjashtim nga TVSH-ja nr.10, (1086/1 prot.), datë 19.06.2018 me afat vlefshmërie deri 25.06.2018. Subjekti ka importuar makineri me kod Shtesë IP0, Kodi i procedurës të zgjeruar 4000, sipas autorizimit të përjashtimit nga TVSH të cituar më sipër sipas deklarates doganore R 1490 date 20.06.2018 dhe R 1488 date 20.06.2018.

Rezulton se, subjekti nuk ka kryer veprimtari ekonomike nën regjimin e RPA, si e till nuk u ka dhënë destinacion doganor mallrave të përjashtuar. Në nenin 9, të VKM-së nr. 953 dt., 29.12.2014, 'Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014' neni 8. Shkresës nr.27864/1 prot, datë 21.11.2014 të DPD. parashikohet që nëse brenda 3 (tre) vjetësh nga momenti i marrjes së autorizimit të përjashtimit nga TVSH-ja, operatori ekonomik nuk ka kryer aktivitet përpunimi aktiv (import-rieksport mallrash nën regjimin e përpunimit aktiv), automatikisht duhet të paguajë tatimin e vlerës së shtuar, për të cilin ka përfituar përjashtimin përkatës.

Fakti që, subjekti nuk kanë kryer asnje investim, nuk kanë vënë makineritë në funksion ekonomik të autorizimeve, nuk kanë njoftuar autoritetet doganore mbikqyrëse për ndryshim të rrethanave ekonomike të tij, përbën shkelje doganore.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 28/1/2,250/1a/4, 253/b.c, 258/1.a dhe 276 të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) ndaj këtij subjekti

V E N D O S A :

- Te paguaje detyrimin doganor ne shumen **28 959 (Njezete e tete mije e nenteqind e pesedhjetë e nente) leke**
- Te denoje me gjobe ne shumen **86 877 (Tetedhjetë e gjashtë mije e teteqind e shtatedhjetë e shtate) leke.**
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejë menjëherë kontabilizimin e shumes se mesiperme.

Kundër këtij vendimi, subjekti "**AMN - GROUP ALBANIA**" – Shpk me NIPT **L77524301J** , lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*".

Artan SULEJMANI

KRYETAR

